



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 01/04/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje bazë materiale për ndërtimin e trotuareve dhe rehabilitimin e shesheve”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale ndërtimi dhe produkte ndihmëse për ndërtimin 44

VLERA E FONDIT LIMIT 7,083,042 (shtatë milion e tetëdhjetë e tre mijë e dyzet e dy) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale për vitin 2025, për objektin: “Blerje bazë materiale për ndërtimin e trotuareve dhe rehabilitimin e shesheve”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqes xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit.** *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

7,083,042 x 40% = 2,833,216.8 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve

vendore per vitin 2024 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

7,083,042 x 20% = 1,416,608.4 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që garancia e mallrave do të jetë 1(një) vit nga momenti i marrjes në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe se marrin përsipër furnizimin e mallit në destinacionin e kërkuar dhe brenda afatit të levrimit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20ton	në pronësi ose me qera	Copë	2
2	Kamion shkarkues (me vinç)	në pronësi ose me qera	Copë	1
3	Autobetoniere	në pronësi ose me qera	Copë	1
4	Autopomp betoni	në pronësi ose me qera	Copë	1

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qira, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- certifikata e kontrollit teknik të mjetit,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura.

(të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit) .

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në shtojcën 8 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor gjate procesit te vleresimit te ofertave.*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të

paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar volumeve të punimeve, orëve të punës dhe kohëzgjatjes së punimeve për të cilat nevojiten këto materiale objekt prokurimi. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Këto mjete janë kërkuar nisur nga sasia e konsiderueshme e mallrave objekt prokurimi. Gjithashtu furnizimi i sasisë së materialit objekt prokurimi kërkon si nevojshmëri për realizimin e kontratës dy mjetet të cilët do të furnizojnë sipas nevojave të AK mallin e kërkuar në prani të komisionit dhe stafit teknik të Agjencisë së Shërbimeve Publike të cilët do të kryejnë proceset e tjera.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesi autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për materialin hekur klasa do jetë S-450.

- a. Hekur betoni periodik 6-10 mm²,
- b. Hekur betoni periodik >12mm²,
- c. Pllaka totuari granili me bojë,
- d. Betoforma, lëndë e sharruar (binar).

Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 5/a dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë

*cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Materialet duhet të plotësojnë kriteret dhe specifikimet e mëposhtme:

1. Pllaka trotuari

- Trashësi: t=6cm.

- Ngjyra: Të ndryshme (gri/kuqe etj)

2. Çimento 32.5 N duhet të jetë në përputhje me EN 206-1 dhe EN 197-1.

-Paketimi: 50kg

Çimento duhet të shpërndahet në paketa origjinale të shenuara të pa demtuara direkt nga Fabrika.

Çimentoja duhet të depozitohet në ambiente pa lagështirë dhe që nuk lejojnë lagjen e saj nga uji dhe shirat.

3. Hekur betoni periodik Ø6-14 mm.

Shufrat e çelikut duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Eurokodit 2, EN 10080 ose me standardet më të fundit të aplikuara.

Çeliku i armimit do të jetë i klasës S500 dhe pa prezencë ndryshku.

4. Bordura betoni 15x30cm të parapergatitura.

-Ngjyra: Gri

Bordurat duhet të jenë betoni me permasa (15x30x100 cm). Ato nuk duhet të kenë plasaritje.

5. Inertet

Për prodhimin e betonit realizimi duhet të bëhet duke respektuar Agregatet duhet të zgjidhen në përputhje me DIN EN 206. Ato duhet të jenë të fortë dhe të qendrueshem dhe nuk duhet të

permbajnë materiale të dëmshme që veprojnë kundër fortësisë ose qëndrueshmërisë së betonit ose, në rast të betonarmesë mund të shkatërrojnë këtë përforcim.

- Zalli i larë do të jetë i madhësisë 5-20mm
- Rëra e larë do të jetë me madhësi kokrrize 5mm
- Çakëlli do të jetë “çakëll makinerie” me madhësi 2-10 cm
- Granili do të jetë i madhësisë 5mm
- Rëra e lumit do të jetë e pastër, pa dhera dhe përmbajtje argjile.
- Stabilizanti do të jetë me madhësi të kokrizës nga 0 deri në 2 cm

6. Lëndë e sharruar druri 2.5 cm

- Druri duhet të jetë me dimensionet $b= 2.5\text{cm}$, $t=10\text{cm}$, $L=4\text{m}$

7. Gozhdë

- Materiali Hekur
- Përdorimi: Dru

8. Boje Vaji

- Ngjyra: E zeze
- Paketimi: 0.75 L
- Hollimi: 5-10% dilyent

9. Bojë antiruxho

- Paketimi: 0.75 L
- Mbulimi: per mbulim te plote 10-12 m²/l
- Koha e tharjes: Koha e plote e tharjes 30 min
- Hollimi: Me 5-10 % ne volum.

10. Zgara 15x15 Φ 6 (2x2m)

- Zgara e hekurit do jenë të parapërgatitura me hekur $\Phi 6\text{mm}$ me dimensione të thurjes (15x15)cm dhe dimension total i zgarave (200x200)cm.
- Total: 80 copë (12,43 kg/copë).

11. Tapa plastike për kangjella metalike

- Dimensionet (50x50)mm
- Ngjyra: E zezë

12. Beton C20/25 (I gatshëm)

Furnizimi dhe ruajtja

Betoni i parapërgatitur në fabrikë nuk duhet të furnizohet pa u vendosur të gjitha kallëpet, armimet dhe elementët e tjerë të lidhura me to. Betoni duhet të jetë në konformitet të plotë me pjesët e aplikueshme të standartit DIN EN 206-1.

Materialet duhet të magazinohen në paketimin e tyre origjinal të padëmtuar në një vend të mbrojtur nga elementët dhe të thatë, deri sa të jenë të gatshëm për përdorim.

Çimentoja dhe përbërësit e saj duhet të ruhen veçmas nga materialet e tjera të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe që mund të dëmtojnë cilësinë e tij.

Betoni i parapërgatitur në kushtet e fabrikës:

Betoni i parapërgatitur duhet të furnizohet me kamion përzierës dhe do të pranohet nëse është në përputhje me kërkesat e standardit DIN EN 206-1.

Prodhuesi i betonit të parapërgatitur duhet të paraqesë fletën e furnizimit për çdo ngarkesë betoni në dy kopje. Përveç kërkesave të standartit DIN EN 206-1, fleta e furnizimit duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm:

- Tipi dhe marka e çimentos
- Përqindja e çimentos për çdo metër kub beton
- Madhësia maksimale e agregateve
- Sasia totale e ujit e shprehur si raport Ujë/Çimento
- Numri i identifikimit të kamionit
- Volumi i betonit në kamion
- Koha e prodhimit

Betoni duhet të përzieret vazhdimisht dhe fleta e furnizimit duhet të kërkohet për çdo ngarkesë që është gati për tu përdorur. Përzierja e betonit duhet të fillojë brenda 30 minutash pasi çimentos i janë shtuar agregatet.

Përzierje betoni M 100

- masa maksimale e agregatit 10 mm
- përmbajtja minimale në çimento 240 kg/m³
- maksimum ujë i palidhur/çimento 0.8

Përzierje betoni M 150

- masa maksimale e agregatit 20 mm
- përmbajtja minimale në çimento 250 kg/m³
- raporti maksimal ujë i palidhur/çimento 0.65

Hedhja e Betonit në kallëp:

Betoni duhet të hidhet në kallëp brenda 90 minutave nga përzierja e ujit me çimenton në qoftë se temperatura e ajrit është më pak se 30 gradë Celsius. Kjo kohë duhet reduktuar në 60 minuta në qoftë se temperatura e ajrit është më e madhe se 30 gradë Celsius.

Betoni nuk duhet të hidhet në kallëp nëse:

- (a) kushtet e motit pengojnë hedhjen e betonit dhe konsolidimin e tij;
- (b) në zonat e pambuluara gjatë periudhave të reshjeve;
- (c) kur uji është i pranishëm brenda formës.

Para hedhjes së betonit, duhen hequr papastërtitë, mbeturinat e ndërtimit nga betoformat. Betoni nuk do të lejohet të bjerë në rënie të lirë nga një lartësi më e madhe se 3 m për të parandaluar ndarjen e elementeve përbërës.

Sipërfaqja duhet të nivelohet duke sheshuar të gjitha parregullësitë.

Temperatura minimale e betonit duhet të ruhet mbi 10 gradë celsius. Betoni nuk duhet të hidhet kur temperatura e ambientit është nën 5 gradë Celsius. Temperatura maksimale e betonit duhet të jetë jo më shumë se 32 gradë celsius.

Pompat e Betonit:

Pompa e Betonit do të operohet dhe mirëmbahet në mënyrë që të sigurojë një rrjedhë të vazhdueshme pa krijuar xhepa ajri, ndarje të aggregateve ose ndryshime të uljes së konusit (slump test) me më shumë se 5 centimetra.

Uji për beton

Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë i pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet për përdorim në prodhimin e betonit.

Kallëpet:

Kallëpet duhet të vendosen në mënyrë të saktë dhe të puthiten mirë te cepat për të mos lejuar rrjedhjen e betonit. Nyjet, cepat dhe këndet e ekspozuara duhet të rumbullakosen (me një prerje 20 milimetra) me perjashtim të rasteve kur kjo nuk është e nevojshme. Para vendosjes së kallëpeve ato duhet të lyhen me substanca që parandalojnë ngjitjen e tyre me betonin dhe që nuk lënë shenjë mbi betonin apo kallëpin.

Para se të ripërdoren, të gjitha kallëpet duhet të rikondicionohen dhe të gjitha sipërfaqet e kallëpeve duhet të pastrohen pa shkaktuar dëmtime të sipërfaqes së kallëpeve.

Pozicionimi i armaturave:

Pozicionimi i shufrave të armimit duhet të bazohet në vizatimet e projektit dhe të fiksohet në pozicionin e duhur gjatë gjithë procesit të hedhjes së betonit. Shufrat e armimit duhet të mbahen

të mbështetura mbi blloqe prej betoni ose prej celiku, apo mbi distancues, doreza çeliku, apo fiksues të tjerë që përmbushin të njëjtat funksione.

Hekur betoni periodik Ø6-10 mm

Shufrat e çelikut duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Eurokodit 2, EN 10080. Çeliku i armimit do të jetë i klasës S500 dhe pa prezencë ndryshku.

Preventivat janë hartuar sipas VKM Nr. 216 date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimeve për zerat e punimeve".

Cmimet e zerave që nuk janë në manual, janë vendosur referuar cmimit mesatar të tre ofertave të tregut.

Specifikimet dhe kriteret teknike u hartuan nga **Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit** duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 "Specifikimet teknike" të Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, e nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 "Kërkesat e cilesise" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **14/04/2025, ora 11:00**.

I. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: "**Blerje baze materiale për Rikonstruksionin e Rrethimit të varrezave Publike dhe zgjerimin e rrugeve të Brendshme**".

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Ermenita Mici (specialist fushe)

Mitjon Nikolla